



ANALIZË E POLITIKAVE  
Nr. 1/14 – Shkurt 2014

# LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT: ANALIZË KRAHASUESE MES KOSOVËS DHE KROACISË

Ky projekt është mbështetur nga: Fondi Evropian për Ballkan, një iniciativë e përbashkët e Fondacionit Robert Bosch, Compagnia di San Paolo, Fondacionit ERSTE dhe Fondacionit King Baudouin përmes “Think and Link - Regional Policy Programme” dhe Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Prishtinë.

**European Fund for the Balkans**  
*Bringing the Western Balkans closer to the European Union*



Kingdom of the Netherlands

Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë ato të KIPRED-it dhe nuk duhet të konsiderohen si pikëpamje të Fondit Evropian për Ballkan ose të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Prishtinë.

Përgatitur nga: Ariana Qosaj-Mustafa dhe Violeta Haxholli

Të drejtat autoriale © 2014 i ka KIPRED. Çdo të drejtë e mban autori. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të ribotohet a të ruhet diku me qëllim rishfrytëzimi, të emetohet në kurrfarë forme apo me kurrfarë mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, inçizues apo tjetër, pa u dhënë paraprakisht leja me shkrim nga botuesi. Ju lusim që për informata të kontaktoni në [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) ose +381 38 227 778.

Publikuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave  
Rruga Rexhep Mala, No 5A  
10 000 Prishtine, Kosove  
Tel dhe Fax: +381 38 227 778  
[www.kipred.org](http://www.kipred.org)

## **Përmbajtja**

1	Përmbledhje Ekzekutive .....	4
2	Hyrje .....	5
a)	Mekanizmat e ndërlikuar në luftën kundër korrupsionit.....	8
b)	PSRK vs USKOK.....	12
a.	Rezultatet .....	13
b.	Korniza ligjore e PSRK-së dhe USKOK-ut: Ngjashmëritë dhe dallimet.....	15
c.	Kapacitetet .....	18
c)	Konkluzione dhe Rekomandime .....	21

## 1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK) është institucioni udhëheqës i mandatuar të trajtojë rastet e profilit të lartë të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një analizë krahasuese të luftës së suksesshme kundër korrupsionit në Kroaci dhe përpjekjet aktuale për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar në Kosovë. Për qëllime të këtij raporti Zyra për Luftën Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (USKOK) në Kroaci do të përdoret si një shembull krahasues dhe model për PSRK-në në Kosovë për të mësuar dhe për të rritur efikasitetin e saj.

Institucionet në Kosovë kanë krijuar një kornizë institucionale dhe ligjore për t'u ballafaquar me këtë problem dhe kanë azhurnuar këtë kornizë shumë herë për shkak të dështimeve të tyre të vazhdueshme. Disa hapa janë ndërmarrë në luftimin e kësaj dukurie, ndërsa disa ligje janë miratuar si: Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit,<sup>1</sup> Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik<sup>2</sup> dhe Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike.<sup>3</sup> Gjithashtu, Qeveria e Kosovës (QeK) ka hartuar dy strategji: Strategjinë kundër Korrupsionit dhe Planin e Veprimit për vitin 2009-2011<sup>4</sup>, dhe së fundi Strategjinë Kundër Korrupsionit dhe Planin e Veprimit për vitin 2013-2017, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës,<sup>5</sup> i cili është përballur me vonesa për miratim për gati dy vjet. Ky është një dokument themelor në përmbushjen e kriterëve afatshkurtra të kërkuara nga Kosova në mënyrë që të përparojë në dialogun për liberalizimin e vizave dhe ishte një parakusht për Kosovën që të merr një përgjigje pozitive në lidhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA).

Megjithatë, egziston një mungesë serioze në përmirësimin e luftës kundër korrupsionit për shkak të shumë mekanizmave institucional të mandatuar për të luftuar korrupsionin me mandate të paqarta dhe përplasje të mandateve, si dhe mungesa e llogaridhënies nga ana e institucioneve për të ndjekur siç duhet dhe për të përmirësuar implementimin e politikave kundër-korrupsionit. Në Raportin e Progresit të vitit 2013 gjithashtu është vërejtur se rezultatet në luftën kundër korrupsionit ishin të kufizuara.<sup>6</sup> Duke mos i përfshirë institucionet e Kosovës, misioni i sundimit të ligjit EULEX i Bashkimit Evropian (BE), ka gjithashtu mandatin për të luftuar korrupsionin. Edhe pse e tërë makineria institucionale dhe ligjore është në dispozicion, korrupsioni i nivelit të lartë vazhdon të jetë i pranishëm në Kosovë. Pasi që Kosova në mesin e prioriteteve kryesore e ka përcaktuar integrimin në BE, krijimi i një kuadri efektiv institucional dhe ligjor për t'u ballafaquar me çështjen e korrupsionit është me rëndësi thelbësore.

Bashkimi Evropian gjithashtu ka raportuar se korrupsioni është një nga komponentët negative të Kosovës dhe vazhdimisht jep rekomandime se këtë fenomen duhet luftuar.<sup>7</sup> Studimi i fizibilitetit i BE-së për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit mes BE-së dhe Kosovës në mënyrë të qartë thekson se Kosova duhet të japë rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë të dhëna për zbatimin e ligjeve kundër korrupsionit, zbatimin efektiv të legjislationit anti-korrupsion të

<sup>1</sup> Shih Ligjin në, <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009-159-ang.pdf>

<sup>2</sup> Shih Ligjin në, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20declaration%20of%20property%20of%20senior%20public%20officials.pdf>

<sup>3</sup> Shih Ligjin në, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2007\\_02-L133\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2007_02-L133_en.pdf)

<sup>4</sup> Kuvendi i Kosovës Seanca Plenare më 12 tetor, 2009, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,159,2615>

<sup>5</sup> Kuvendi i Kosovës Seanca Plenare më 11 shkurt 2013, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,159,4737>

<sup>6</sup> Shih faqën 13, Raporti i Progresit i KE për Kosovën 2013, në [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/brochures/kosovo\\_2013.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf)

<sup>7</sup> Shih raportin vjetor për progresin e Kosovës nga BE, <http://ec.europa.eu/enlargement/countries/strategy-and-progress-report/>

Kosovës dhe krijimin e mekanizmave efektive për parandalimin e korrupsionit.<sup>8</sup> E njëjta rëndësi i është dhënë në Udhërrëfyesin e Liberalizimit të Vizave dhe Dialogut të Strukturuar për Sundimin e Ligjit në Kosovë. Në Raportin e Progresit të vitit 2013 gjithashtu është dhënë vërejtja se përpjekje të vazhdueshme janë të nevojshme për të siguruar përgjegjshmërinë e zyrtarëve të lartë dhe politikanëve.<sup>9</sup>

Ky raport, analizë e politikave arrin në konkludimin se krijimi i organeve të shumta për të luftuar korrupsionin ka shkaktuar një përplasje të mandateve, joefikasitet, rritje të mungesës së përgjegjësisë dhe ka ulur numrin e dënimeve. Kjo duket të jetë një taktikë e qeverisë që praktikohet në vazhdimësi për të krijuar dhe caktuar Koordinatorë të ri ose Task Forca posa rritet presioni nga BE-ja. Krijimi dhe caktimi i mekanizmave të ndryshëm dhe krijimi i task forcave rrezikon zbatimin e ligjeve dhe politikave ekzistuese duke shpenzuar buxhetin në drejtime të ndryshme ndërsa rezultatet në luftën kundër korrupsionit duken të dobëta dhe numri i dënimeve mbetet i ulët. Si shtesë, përderisa numri i kallzimeve penale është rritur në nivelin e përgjithshëm të prokurorit të shtetit nga 362 raste në vitin 2009 në 628 raste deri në shtator 2013,<sup>10</sup> numri i lëndëve të pazgjidhura është shqetësues kryesisht duke u ballafaquar me raste të vogla të korrupsionit kështu duke zhvendosur vëmendjen nga rastet e profilit të lartë.

Thjeshtësimi i rolit dhe përgjegjësisë së secilit institucion me institucionet udhëheqëse të caktuara në luftën kundër korrupsionit është shansë që Kosova nuk duhet të humbasë. Ky është mësimi kyq i mësuar nga rasti i Kroacisë. Për më tepër, reformat në vazhdim e sipër në mandatin aktual të EULEX-it kombinuar me një kushtëzim të fortë nga ana e BE-së ndaj institucioneve të Kosovës duhet të përfshijë transferimin e kompetencave të organeve të sundimit të ligjit në strukturat vendore, krahas me rritjen e kapaciteteve të tyre.

## 2 HYRJE

Në mes të gjitha ligjeve, politikave dhe mekanizmave Kosova vazhdon të renditet lartë kur është fjala për nivelin e korrupsionit.<sup>11</sup> Qeveria e Kosovës vazhdon të deklarojë në mënyrë retorike që zbatimi i ligjit është në mesin e prioritetëve kryesorë<sup>12</sup> të saj e në anën tjetër në praktikë Qeveria e Kosovës u ka dhënë prioritet investimeve në infrastrukturë në kuptim të shpenzimeve buxhetore, dhe pjesa e buxhetit për sundimin e ligjit është zvogëluar.

Ndarja buxhetore është një indikator i besueshëm për të treguar trendet e mbështetjes dhe prioritetëve të qeverisë. Shpenzimet buxhetore të përgjithshme të Kosovës për vitin 2013 janë mbi 20 % më të ulëta krahasuar me vitin e kaluar. Ky është i vetmi vit ku një rënie në shpenzimet e shtetit është vërejtur që nga viti 2009.<sup>13</sup> Rënia e përgjithshme vjetore e buxhetit për vitin 2013 ka ndikuar edhe në trendin e uljes së mbështetjes buxhetore për institucionet e sundimit të ligjit. Për vitin 2013 vetëm 2.17 % të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore janë ndarë për tri degët kryesore të

---

<sup>8</sup> Shih, Studimi i Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ne mes të Kosovës dhe EU-së, [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_feasibility\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_feasibility_2012_en.pdf)

<sup>9</sup> Shih faqe 12, Raporti i Progresit për Kosoven 2013, [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/brochures/kosovo\\_2013.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf)

<sup>10</sup> Komunikim me e-mail i KIPRED me zyrtarë të Prokurorisë, dhjetor 2013.

<sup>11</sup> Shih, Transparency International, Corruption Perceptions Index, Kosovo, <http://www.transparency.org/cpi2013/results>

<sup>12</sup> “Kosovë, Kuçi: Sundimi i ligjit, prioritet i qeverisë”, LajmeShqip, 14 qershor, 2011, <http://www.lajmeshqip.com/kombetare/kosove-kuçi-sundimi-i-ligjit-prioritet-i-qeverise>

<sup>13</sup> Shih tabelat vjetore të buxhetit qendror, <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiqtendrore.aspx>

drejtësisë, hetimeve, ndjekjeve penale dhe gjykatave.<sup>14</sup> Edhe pse buxheti i përgjithshëm për prokurorët special është rritur në vitin 2011 dhe 2012 në krahasim me vitin 2010, në vitin 2013 burimet financiare për prokurorët special janë zvogëluar në një masë të madhe. Një rënie edhe më e madhe në buxhet ka ndikuar drejtpërdrejt tek operacionet speciale të Policisë.<sup>15</sup> Buxheti i ndarë për operacione speciale të policisë ka rënë nga 5.4 milionë euro në 2012 në 526,893 euro në vitin 2013.<sup>16</sup>

Përveç kësaj, disa të dhëna shqetësuese janë raportuar edhe në Barometrin Global të Korrupsionit 2013<sup>17</sup> të kryer nga Transparency International (TI). Sipas këtij barometri, përqindja e të anketuarve të cilët kanë raportuar se kanë paguar ryshfet në vitin 2012 për ndonjë nga tetë ofruesit e shërbimeve në Kosovë është 16 %. Institucioni i cili ka rezultuar me përqindjen më të lartë në nivelin e perceptuar të korrupsionit, në mesin e 12 institucioneve kryesore në lidhje me institucionet më të korruptuara në vend, është gjyqësia e Kosovës e cila shënoi 4.3 pasuar nga partitë politike me 4.2.<sup>18</sup>

Përveç qytetarëve, bizneset kanë raportuar gjithashtu të paguajnë ryshfet në një masë të madhe. Si shtesë, bizneset raportohet të paguajnë 1 ryshfet çdo shtatë javë që është mesatarisht 7.7 ryshfete në vit. Është interesante se në 38% të rasteve bizneset kanë ofruar ryshfete me iniciative të tyre. Përdryshe mbi 50% të ryshfeteve kërkohen nga zyrtarët publik kryesisht nga zyrtarët doganor (1.9 %), zyrtarët e taksave (1.8 %), zyrtarët provincial dhe komunal.<sup>19</sup> Si arsye për dhënie të ryshfetit bizneset listojnë faktorë të ndryshëm si: fuqinë e madhe të këtyre zyrtarëve, mungesa e integritetit të zyrtarëve, pagat e ulëta të zyrtarëve publikë, dhe ndikimi i individëve të fuqishëm të korruptuar përcjellur nga mungesa e llogaridhënies.<sup>20</sup>

Pavarësisht nga prania e lartë e korrupsionit, reagimi nga institucionet e Kosovës ka qenë i ulët në krahasim me shkallën e korrupsionit. Edhe pse numri i akuzave të reja penale për vepra penale të korrupsionit që trajtohen nga Prokuroria është rritur gjatë gjashtë viteve të fundit,<sup>21</sup> numri i lëndëve të pazgjidhura vazhdon të jetë i lartë, me një mesatare prej 54 % të rasteve penale të pazgjidhura.<sup>22</sup> Këto statistika janë të ndikuara edhe nga grumbullimi i rasteve në zyrat e prokurorëve që janë rritur në baza vjetore duke filluar nga 123 kallëzime penale në vitin 2009 trashëguar nga viti 2008, në 307 kallëzime penale në vitin 2013<sup>23</sup> (shih tabelën 1.1).

---

<sup>14</sup> Shih tabelat vjetore të buxhetit qendror, <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxheti-qendrore.aspx>

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> Shih tabelat vjetore të buxhetit qendror, <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxheti-qendrore.aspx>

<sup>17</sup> Ky barometer bazohet në një studim të më shumë se 114,000 personave nga 107 shtete. I adreson përvojat e drejtpërdrejta të njerëzve me ryshfet dhe pikpamjet e tyre për korrupsion në institucionet kryesore në shtetet e tyre. Gjithashtu ofron njohuri mbi gatitshmërinë e njerëzve për të ndaluar korrupsionin.

<sup>18</sup> Sipas Barometrit të Transparency International në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 do të thotë 'nuk është korruptuar' dhe 5 do të thotë 'jashtëzakonisht të korruptuar'. Edhe institucionet e tjera në vijim të perceptimit të Barometrit në Kosovë janë Mjekësia dhe Shëndetësia 4.0, Parlamenti / Legjislativi 3.9, Biznesi/ Sektorët privat 3.5, Zyrtarë Publik / Nëpunësit Civil 3.3, të ngjashme si Sistemi i Arsimit, Policia 3.1, Mediat 3.0, OJQ-të 2.3, Organet Fetare 2.0, Ushtria 1.6. Shih <http://www.transparency.org/cpi2013/results>


<sup>19</sup> Shih biznesi, korrupsioni dhe krimi në Kosovë: Ndikimi i ryshfetit dhe rimeve të tjera në ndërmarrje private, Raporti i UNODC 2013 në, [http://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Kosovo\\_Business\\_corruption\\_report\\_EN.pdf](http://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Kosovo_Business_corruption_report_EN.pdf)

<sup>20</sup> Po aty.

<sup>21</sup> 2008: 227, 2009: 239, 2010: 263, 2011: 370, 2012: 376 dhe deri 30 shtator 2013: 321 (Komunikim me e-mail i KIPRED me zyrtarë të Prokurorisë, dhjetor 2013)

<sup>22</sup> Në 2009, 155 kallëzime penale mbetën të pazgjidhura nga 362 të vjetra dhe kallzime penale të reja që trajtohen nga zyra e Prokurorisë; në 2010: 282 prej 418; 2011: 267 prej 652; 2012: 277 prej 643;

<sup>23</sup> Në 2010: 155 kallzime penale janë trashëguar nga viti i kaluar; 2011: 282; 2012: 267.



Kur është fjala për gjykatat, ka pasur një rritje të rasteve të zgjidhura. Në vitin 2011 gjykatat kanë zgjidhur 136 raste<sup>24</sup> ndërsa në vitin 2012 ka pasur 183 raste të zgjidhura.<sup>25</sup> Megjithatë, dënimet me burg për veprat penale të korrupsionit kanë qenë të ulëta. Në vitin 2012, nga 183 raste, vetëm 10 % e tyre ose 19 raste janë sanksionuar me burgim. Një vit më parë kjo përqindje ishte pak më e lartë. Prej 136 rasteve të zgjidhura nga gjykatat në vitin 2011, 15 % e tyre ose 20 raste janë sanksionuar me burgim. Ankesat bëhen ndaj rasteve edhe në gjykata të shkallës së dytë, rastet ri-përsëriten dhe dënimet mund të zvogëlohen. Një analizë e përgjithshme e mekanizmit të gjurmimit për të monitoruar zhvillimin e rasteve prej aktakuzës, dënimit, ankesës dhe aktgjykimit përfundimtar janë të nevojshme për të treguar zbatimin e masave anti-korrupsion. Gjithashtu Bashkimi Evropian ka shprehur nevojën për të monitoruar edhe aktgjykimet përfundimtare të krimeve të korrupsionit si kriter për liberalizim të vizave për Kosovën.<sup>26</sup>

Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) është ballafaquar me kundërvajtje korrupsioni megjithatë ka treguar rezultate minimale. Numri i aktakuzave që rrjedhin nga rastet që AKK-ja ka paraqitur prokurorëve dhe policisë për procedim të mëtejshëm ka qenë shumë i ulët. Prej 52 rasteve të paraqitura nga AKK-ja në vitin 2012 vetëm 7 prej tyre rezultuan në aktakuza nga ana e prokurorëve. E njëjta gjë ka ndodhur në vitin 2011 ndërsa numrat ishin edhe më të ulët në vitet e kaluara.

Përveç organeve të sundimit të ligjit në Kosovë, që nga viti 2008 EULEX-i e ka ndihmuar Kosovën në ballafaqimin me korrupsion dhe kundërvajtje të tjera në veçanti të profilit të lartë. Megjithatë, rezultatet e tij nuk kanë qenë shumë të kënaqshme. Vetëm nën udhëheqjen e civilit Gjerman të emëruar si Udhëheqës i Misionit Bernd Borchardt janë shënuar rezultate më të dukshme në hetime dhe aktakuza të disa rasteve të profilit të lartë. Megjithatë numri i përqindjes së dënimeve mbetet për t'u parë.

Nga viti 2008 deri në nëntor 2013, janë zhvilluar 266 hetime, prokurorët e EULEX-it kanë arritur të paraqesin vetëm 16 aktakuza lidhur me veprat penale të korrupsionit ose vetëm 6%.<sup>27</sup> Prokurorët deklarojnë se dëshmitarët ngurrojnë apo tërhiqen nga deklaratat e tyre posa fillojnë hetimet.<sup>28</sup> Në

---

<sup>24</sup> Shih faqe 11, analizën e Agjencisë Kundër Korrupsionit për ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit në Kosovë 2012, <http://www.akks.org/repository/docs/0.07%20Raporti%20me%20statisikat%202012%20versioni%20perfundimtar%20shqip.pdf>


<sup>25</sup> Shih faqe 11, analizën e Agjencisë Kundër Korrupsionit për ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit në Kosovë 2013, [http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raport\\_Analize\\_2012%20%281%29.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raport_Analize_2012%20%281%29.pdf)

<sup>26</sup> Faqja 11 e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave me Kosovën.

<sup>27</sup> Në 2008-2009 ka pasur 46 hetime të cilat kanë rezultuar me 2 aktakuza, në vitin 2010 nga 44 hetime kanë qenë 3 aktakuza, në vitin 2011 ka pasur 68 hetime me vetëm 3 aktakuza dhe në vitin 2012 nga 64 raste janë hetuar dhe ndaj 4 individëve është ngritur aktakuza dhe deri në nëntor 2013 ishin 44 hetime dhe vetëm 4 aktakuza. Komunikim me e-mail i KIPRED me zyrtarët e EULEX-it, dhjetor 2013.

<sup>28</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë vendorë, dhjetor 2013.

raste të tjera, hetime policore të inteligjencës nuk përfundohen kurse hetuesve të EULEX-it iu mungon njohja e kontekstit, gjuhës dhe mentalitetit të Kosovës që në mënyrë të suksesshme të ndjekin rastet<sup>29</sup> (shih tabelën 1.2).




Nga viti 2008 deri në nëntor 2013 gjyqtarët e EULEX-it kanë lëshuar 43 aktgjykime për vepra penale në lidhje me korrupsion. Gjyqtarët gjetën 56 individë fajtor për veprat penale të korrupsionit ndërsa 30 persona të pafajshëm.<sup>30</sup>

Edhe pse prokurorët vendor i kanë kushtuar vëmendje rritjes së numrit të raporteve në luftë kundër korrupsionit për shkak të kërkesave të BE-së për liberalizimin e vizave, prokurorët vendorë kanë qëndruar larg nga rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, kryesisht duke trajtuar raste më të lehta të korrupsionit. Rastet të profilit të lartë janë trajtuar kryesisht nga prokurorët e EULEX-it.

#### a) MEKANIZMAT E NDËRLIKUAR NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Ka një mungesë serioze të përmirësimit në luftën kundër korrupsionit, veçanërisht për shkak të shumë mekanizmave që kanë mandat të paqartë dhe përplasje të mandateve. Gjithashtu mungesa e qëllimeve të duhura nga institucionet kryesore për të krijuar mekanizma efikas të korrupsionit dhe krijimi i organeve të shumta dhe të ndërlikuar kanë bërë që rezultatet e përgjithshme të jenë të dobëta.



<sup>29</sup> Burim i KIPRED, Hetues i Policisë së Kosovës, 2012.

<sup>30</sup> Komunikim me e-mail i KIPRED me zyrtarë të EULEX-it, dhjetor 2013.



Fig.1.1 Mekanizma të ndryshëm në luftë kundër korrupsionit

**AKK (2007):** Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), e krijuar në vitin 2007 si një institucion i pavarur për të verifikuar dhe raportuar mbi pasurinë e deklaruar të zyrtarëve shtetërorë dhe për konflikt të interesit,<sup>31</sup> vazhdon të jetë nën kritika të vazhdueshme nga ana e institucioneve<sup>32</sup> shtetërore dhe nga partitë opozitare.<sup>33</sup> Mandati AKK-së për të verifikuar pasurinë e deklaruar nga zyrtarët e shtetit ka mbetur i mbërthyer në një harresë, pa fuqi të mjaftueshme hetimore, shpesh duke dhënë rezultate të kufizuara në luftë kundër korrupsionit. Kjo tregohet edhe nga të dhënat statistikore të dhëna nga vet Agjencia. Nga numri i përgjithshëm i rasteve për periudhën prej 2008 deri 2012 të raportuara nga AKK që janë dërguar prokurorëve të Kosovës dhe Policisë, vetëm 9.39 % të këtyre rasteve përfunduan me aktakuza të ngritura nga ana e Prokurorisë.<sup>34</sup> Kreu i AKK-së Hasan Preteni ka shprehur shqetësimin e tij tek KIPRED-i lidhur me kornizën ligjore ekzistuese e cila ofron qasje të kufizuara për AKK në verifikimin e origjinës së aseteve të raportuara nga zyrtarët e shtetit ose nuk i detyron zyrtarët që të vërtetojnë origjinën e pasurisë së tyre.<sup>35</sup> Kjo e ka arsyetuar situatën ndërsa AKK ka qenë e kufizuar dhe ka ushtruar një kontroll të pjesshëm, por jo të plotë në deklarimin e pasurive të të gjithë zyrtarëve publik.<sup>36</sup>

**PSRK (2008):** Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës është themeluar me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës ( Ligji nr 03/L-052),<sup>37</sup> i miratuar në mars 2008, si një nga ligjet në pakon e Ahtisaarit, me qëllim që ti ofrojë Kosovës institucionet e nevojshme për "pavarësi të mbikqyrur". PSRK-ja u bë funksionale me 9 dhjetor 2008 si një "zyrë e përhershme dhe e specializuara e prokurorisë që vepron në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Shtetit në Kosovë". PSRK-ja administrohet nga të dy, autoritetet e Kosovës ( Ministria e Drejtësisë) dhe nga EULEX-i, dhe udhëhiqet nga një prokuror i EULEX-it. Ligji i PSRK-se<sup>38</sup> është hartuar nën udhëheqjen e administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë gjatë vitit 2007 në mënyrë që të përmbushë nevojat e Kosovës për të luftuar krimin e organizuar, pastrimin e parave, terrorizmin, krimet ekonomike dhe krimet e luftës. Misioni ishte i vetdijshëm për rolin e tij të zvogëluar pasi që institucionet e Kosovës shpallen pavarësinë në vitin 2008, kishin për qëllim krijimin e PSRK-së për të siguruar transferimin e rasteve të pazgjidhura të UNMIK-ut<sup>39</sup> në misionin e ri të ardhshëm për sundimin e ligjit EULEX. Që nga themelimi i saj, PSRK-ja u përqendrua kryesisht në çështjet e krimeve të luftës, por në vitet e fundit PSRK-ja i ka kushtuar gjithnjë e më shumë vëmendje rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Megjithatë, rezultatet kanë qenë të kufizuara me një normë prej përafërsisht 26 % të dënimeve për rastet e ngarkuara nga PSRK-ja në vitin 2012. Në krahasim zyra e USKOK në vitin 2012 kishte një normë prej 95 % të dënimeve.

<sup>31</sup> <http://www.akk-ks.org/?cid=2,6>

<sup>32</sup> "Përplasen rreth korrupsionit", Telegrafi, 24 gusht, 2012, <http://www.telegrafi.com/lajme/p-rplasen-rreth-korrupsionit-2-24539.html>

<sup>33</sup> Shih të dhënat e Komisionit të Kuvendit të Kosovës për Legjislacion në, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2013\\_05\\_20\\_12\\_4941\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2013_05_20_12_4941_al.pdf)

<sup>34</sup> Shiko raportet vjetore të AKK-së në, <http://www.akk-ks.org/?cid=1,16>

<sup>35</sup> Intervistë e KIPRED me Hasan Preteni, 13 qershor, 2013

<sup>36</sup> Shih Raportin e KIPRED-it Pandëshkueshmëria në Kosovë: Pasuria e pajustificueshme në, [http://www.kipred.org/advCms/documents/42734\\_Investigating\\_inexplicable\\_wealth\\_ENG.pdf](http://www.kipred.org/advCms/documents/42734_Investigating_inexplicable_wealth_ENG.pdf)

<sup>37</sup> Shih Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës në, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L052\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L052_en.pdf)

<sup>38</sup> Po aty.

<sup>39</sup> Ka pasur 321 raste të bartura nga prokurorët / gjyqtarët e UNMIK-ut për komponentin e drejtësisë së EULEX-it, shih <http://www.eulex-kosovo.eu/en/justice/prosecution.php>

**Task Forca Speciale Anti-Korrupsion e PSRK-së (2010):** Përveç AKK-së, pasi që avancimi në luftën kundër korrupsionit nuk pati sukses, Qeveria e Kosovës lëshoi një vendim në shkurt 2010,<sup>40</sup> për të krijuar Task Forcën Speciale Kundër Korrupsionit në kuadër të PSRK-së me detyrën e saj kryesore për të luftuar korrupsionin e nivelit të lartë.<sup>41</sup> Vendimi thekson se në bashkëpunim me EULEX-in, qeveria e Kosovës kërkon nga PSRK-ja të krijoj një departament special anti-korrupsion të përbërë nga prokurorë ndërkombëtarë, prokurorë vendorë, persona me njohuri mbi tatimet dhe 30 zyrtarë të policisë të përzgjedhur nga Qeveria e Kosovës.<sup>42</sup> Mandati i Task Forcës është të hulumtoj dhe të luftoj fenomenin negativ të korrupsionit në Kosovë.<sup>43</sup> Vendimi ka garantuar edhe mbrojtje për prokurorët dhe familjet e tyre por kjo nuk është aplikuar në praktikë. Në një vizitë në PSRK, Shefi i misionit të EULEX-it, Yves de Kermabon iu ka referuar themelimit të kësaj Task Force "një sinjal i fortë nga qeveria për të luftuar kundër korrupsionit",<sup>44</sup> ndërsa përfaqësuesit e shoqërisë civile shprehën dyshimet e tyre për efikasitetin e kësaj task force.<sup>45</sup> Kredibiliteti i saj u zvogëluar edhe më tej kur kreu i kësaj Task Force Nazmi Mustafi u arrestua nga policia e EULEX-it në prill 2012. Ai u akuzua për veprën penale të kërkim rryshfeti nga individë që janë nën hetim nga ana e PSRK-së në këmbim të lirimit të tyre. Ai u gjet fajtor së bashku me tre të tjerë për korrupsion dhe shkelje të tjera të ngjashme.<sup>46</sup> Për më tepër, pas arrestimit dhe dënimit të kreut të Task Forcës një udheheqës i ri Task Forcës ende pret emërimin.

**Koordinatori Kombëtar për Luftën Kundër Korrupsionit – Zyra e Prokurorisë së Shtetit (2010):** Në vitin 2010 Prokuroria e Shtetit të Kosovës emëroi një koordinator mes prokurorëve të shtetit për të koordinuar luftën aktuale të prokurorisë së shtetit ndaj korrupsionit. Në vitin 2012 koordinatori i emëruar është konfirmuar pas kërkesave që vijnë nga Kriteret e Liberalizimit të Vizave për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Zyrës së Prokurorit të Shtetit.<sup>47</sup> Vendimi i lëshuar detyron koordinatorin të raportojë çdo ditë për aktivitetet e tij dhe të raportojë Sekretariatit të KPK-së çdo të hënë lidhur me aktivitetet e Sistemit të Prokurorisë, Zyrës së Prokurorit të Shtetit dhe zyrtarit përgjegjës për proceset e Integritetit Evropian.<sup>48</sup> Koordinatorin mbetet i përfshirë kryesisht në koordinimin e raportimit të zyrës së prokurorisë shtetërore në luftë kundër korrupsionit.

**Këshilli Kombëtar kundër Korrupsionit (2012):** Me qëllim për të rritur më tej përpjekjet e institucioneve të Kosovës në shkurt të vitit 2012 Presidentja e Kosovës themeloi një organ tjetër për të luftuar korrupsionin përkatësisht Këshillin Kombëtar kundër Korrupsionit. Megjithatë ky organ nuk ka prodhuar rezultate dhe vetëm ka degraduar performancën e tij duke raportuar dhe duke minimizuar rolin e tij koordinues, rolin e forcimit të mekanizmave ekzistues në luftën kundër korrupsionit dhe iniciimin ose përmirësimin e ligjeve për të luftuar korrupsionin në pajtim me

---

<sup>40</sup> Vendimi i Qeverisë së Kosovës i datës 26 shkurt, 2010, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_110\\_-\\_te\\_te\\_Qeverise\\_2010.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_110_-_te_te_Qeverise_2010.pdf)

<sup>41</sup> Komunikatë për shtyp e EULEX-it, "Fokus i Organit të Ri, Krimit e Profilit të Lartë", 23 prill, 2010, <http://www.eulex-kosovo.eu/en/news/000218.php>

<sup>42</sup> Pikat e vendimit të Qeverisë së Kosovës 1, 2, 3, 4. Shih vendimin e nënshkruar nga kryeministri Hashim Thaçi më 26 shkurt 2010 në [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_110\\_-\\_te\\_te\\_Qeverise\\_2010.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_110_-_te_te_Qeverise_2010.pdf)

<sup>43</sup> Po aty.

<sup>44</sup> Shënimin e mësipërm në 40.

<sup>45</sup> Deklaratë e Avni Zogianit, Organizata ÇOHU, <http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/416288/titulli/Korrupsioni-krijohet-zyra-speciale-ne-Prokurorine-e-Kosoves>

<sup>46</sup> Komunikatë për shtyp e EULEX-it, "Përmbledhje e procedurës së Drejtësisë në maj", 11 qershor, 2013, <http://www.eulex-kosovo.eu/en/executive/00014.php>

<sup>47</sup> Shih vendimin në [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.835.2012-Vendim\\_.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Nr.835.2012-Vendim_.pdf) vendim i 2012

<sup>48</sup> Po aty.

mandatin e tij.<sup>49</sup> Prandaj Këshilli i cili ka qenë paraparë fillimisht të forcoj efikasitetin e institucioneve të Kosovës në luftë kundër korrupsionit mbetet një mekanizem tjetër me rezultate të dobëta në mesin e shumë mekanizmave tjerë në Kosovë. Rezultatet e dobëta janë shënuar edhe në Raportin e Progresit të KE-së për Kosovën 2013.<sup>50</sup>

**Koordinatori Kombëtar Kundër Krimeve Ekonomike (2013):** Pavarësisht nga institucionet e shumta të krijuara me qëllim që të përmirësojnë luftën kundër korrupsionit përsëri në shtator të vitit 2013, me iniciativën e Departamentit të Thesarit të SHBA-ve, përfaqësuesit e organeve të sundimit të ligjit të Kosovës ranë dakord për të krijuar një tjetër organ, Koordinatorin Kombëtar për Luftën kundër Krimeve Ekonomike që do të emërohet nga radhët e prokurorisë.<sup>51</sup> Një memorandum mirëkuptimi u nënshkrua mes disa institucioneve,<sup>52</sup> dhe për bazë ligjore në krijimin e një institucioni tjetër për të luftuar korrupsionin e posaçërisht krimeve ekonomike, është përdorur Rregullorja e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Koordinatori ende nuk është emëruar, por prapë paraqet rrezik për të shkaktuar ndeshje me institucionet ekzistuese duke përfshirë PSRK-në dhe Njësinë e Inteligjencës Financiare të Kosovës me mandate të ngjashme.

**EULEX (2008):** Misioni më i madh i BE-së për Sundimin e Ligjit - EULEX - i është i mandatuar që nga 2008 për të monitoruar, udhëzuar dhe këshilluar autoritetet vendore për çështjet e sundimit të ligjit me zbatim të mandatit ekzekutiv në lidhje me rastet e ndjeshme të tilla si korrupsion të nivelit të lartë nga zyrtarët e shtetit.<sup>53</sup> Rastet e krimeve të rënda kryesisht trajtohen nga zyrtarët e EULEX-it . Udhërrëfyesi i liberalizimit të vizave dhe studimi i fizibilitetit kanë kërkuar që institucionet e Kosovës të sigurojnë bashkëpunim të vazhdueshëm të mirë me EULEX-in.<sup>54</sup>

Megjithatë, misioni është kritikuar vazhdimisht për dështim për të luftuar korrupsionin në nivelet e larta. Paaftësia e EULEX-it për të përmbushur pritjet e larta nga shoqëria kosovare ka ndodhur për shkak të faktorëve të ndryshëm.<sup>55</sup> Një ndër shkaqet është edhe balancimi i qëllimshëm i misionit për të shmangur rastet e korrupsionit të nivelit të lartë për çmimin e sigurimin të stabilitetit politik. Hetimet e mundshme nga EULEX-i dhe aktakuzat ndaj pushtetit të nivelit qendror mund të rrezikojnë të shkaktojnë jostabilitet institucional, gjë që është e papërshtatshme për BE-në, pasi që një sistem i qëndrueshëm i qeverisjes është i nevojshëm për procesin e dialogut mes Kosovës dhe

---

<sup>49</sup> Ndër të tjera AKK-ja duhet të koordinojë aktivitetet e anëtarëve të institucioneve të Këshillit për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit; të përcaktoj prioritetet dhe politikat për implementimin e kornizës ligjore për të luftuar korrupsionin, të koordinoj punën e institucioneve përgjegjëse për të forcuar mekanizmat ekzistues të mandatuara për të luftuar korrupsionin dhe duhet të synoj rritjen e ndërgjegjësimin të publikut të shoqërisë mbi përpjekjet anti-korrupsion. Shih Dekretin e Presidentit DKKK-001-2012 në, <http://gazetazyrtare.rks.gov.net/Documents/Dekret%20per%20Themelimin%20e%20K.K.Korrupsionit%20%28shqip%29.pdf>

<sup>50</sup> Shih faqen 13 të Raportit të Progresit të KE-së për Kosovën, 2013 në

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/brochures/kosovo\\_2013.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf)

<sup>51</sup> Takimi i Ministrisë të Drejtësisë me krerët dhe përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial, Policisë, Agjencisë Kundër Korrupsionit, Agjencia e Inteligjencës, Bankës Qëndrore, Njësia e Inteligjencës Financiare, Gjykatës Supreme, Ministria e Financave dhe Gary Hyde, përfaqësues i Thesarit të SHBA-ve, 23 shtator 2013, <http://www.md-ks.org/?page=1.8.1112>

<sup>52</sup> Ky memorandum u nënshkrua nga krerët e Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Bankën Qendrore të Kosovës, Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. shih në, <http://www.md-ks.org/?page=1.8.1169>

<sup>53</sup> Shih Çfarë është EULEX ? at, <http://www.eulex-kosovo.eu/en/info/whatisEulex.php>

<sup>54</sup> Shih, Studimi i Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit midis BE-së dhe Kosovës në, [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_feasibility\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_feasibility_2012_en.pdf)

<sup>55</sup> Raporti i KIPRED "Analizë Gjithëpërfshirëse E EULEX-it: Çka më tutje?"

[http://www.kipred.org/advCms/documents/56243\\_A\\_Comprehensive\\_Analysis\\_of\\_EULEX.pdf](http://www.kipred.org/advCms/documents/56243_A_Comprehensive_Analysis_of_EULEX.pdf)

Serbisë. Ky proces është i një rëndësie të madhe për BE-në për të siguruar stabilitetin në rajon.<sup>56</sup> Prokurorët vendor gjithashtu besojnë se EULEX-i nganjëherë ka shmangur qëllimisht disa raste të korrupsionit të nivelit të lartë të mbështetur nga raportimi i qytetarëve tek EULEX-i si institucion më i besuar, dhe edhe pse ka pasur dëshmi në raporte, EULEX-i nuk ka ndërmarrë hetime të mëtejshme.<sup>57</sup> Përveç përzgjedhjes së rasteve, në disa raste lëndët janë zhvendosur nga një prokuror tek tjetri për shkak të sistemit të rotacionit të lartë brenda misionit.<sup>58</sup> Përkundër kritikave të mëdha, misioni ka kontribuar në një masë për të parandaluar ndërhyrjet lokale në institucione.<sup>59</sup>

Kërkesat që misioni t'i jep fund mandatit të tij dhe të dorëzojë kompetencat tek vendasit janë rritur kohëve të fundit. Qeveria e Kosovës ka hartuar një strategji për përfundimin e këtij misioni në vitin 2014. Në anën tjetër, zyrtarët e EULEX-it mendojnë se koha e tyre në Kosovë që nga viti 2008 nuk ka qenë e mjaftueshme për të rritur kapacitetet e vendorëve.<sup>60</sup> Prokurorët ndërkombëtarë pretendojnë se prokurorët vendor ende kanë vështirësi për të trajtuar rastet e korrupsionit të profilit të lartë ose të krimin të organizuar megjithatë mungesa e efikasitetit në marrjen e këtyre rasteve është e lidhur edhe me mjedisin e punës për stafin gjyqësor të cilit i mungon mbrojtja e duhur (përfshirë këtu edhe familjet e tyre) për shkak të mangësive të kornizës ligjore.<sup>61</sup> Përderisa misioni i sundimit të ligjit të BE-së planifikon të vazhdoj intervenimin e tij në Kosovë përtej qershorit të 2014 me një mision të ngjashëm, por me fushëveprim më të vogël dhe me një emër tjetër, lufta kundër korrupsionit vazhdon të mbetet në harresë, pa përgjegjësi e arsyetuar me lojra të vazhdueshme fajësimi në mes të prokurorëve vendor dhe ndërkombëtar sikur në kohën e udhëheqjes së Kosovës nga UNMIK-u. Edhe pse prokurorët vendor të PSRK-së kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të luftuar korrupsionin shpesh EULEX-i përdoret si një justifikim për mungesën e iniciativës së tyre që është në kundërshtim me arsyet e krijimit e një PSRK-je të udhëhequr nga ndërkombëtarët, prokurorët e EULEX-it janë bërë një mburojë për joefikasitetin e homologëve të tyre vendor. Në mënyrë të ngjashme, prokurorët e EULEX-it vazhdojnë të shprehin dyshimet e tyre në kapacitetet e prokurorëve vendorë, duke justifikuar kështu nevojën për ekzistencën e tyre.

## b) PSRK vs USKOK

Duke shikuar Kroacinë si një vend që dikur ka qenë pjesë e ish-Jugosllavisë, afërsia rajonale me Kosovën dhe tradita të ngjashme ligjore dhe gjyqësore në të kaluarën, ky raport shikon mësimet e fituara nga një proces i tillë në mënyrë që kontekstualisht të transferoj atë njohuri për avancimin e mëtejshëm të Kosovës në proceset e integritetit në BE. Edhe pse e etiketuar si një nga vendet më të korruptuara në prag të hyrjes në BE,<sup>62</sup> Kroacia arriti të prodhojë rezultate të kënaqshme në luftën e saj kundër korrupsionit. Si një shtet i ri, Kroacia ka luftuar me korrupsion shumë vite pas pavarësisë së saj në vitin 1991 dhe në periudhën e pas luftës që nga viti 1995. Pjesa tjetër e vendeve të Ballkanit Perëndimor që presin për t'u integruar në Bashkimin Evropian shikojnë Kroacinë si një model për të mësuar për përmbushjen e kërkesave të BE-së. Përveç kësaj, vendet e BE-së shpesh përsërisin se vendet e tilla si Kosova duhet të përfitojnë nga mësimet e nxjerra nga Kroacia gjatë rrugës së saj drejt BE-së.

<sup>56</sup> Intervistë e KIPRED me analist politik dhe gazetar, 3 dhjetor, 2012.

<sup>57</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë vendorë, 11 dhjetor, 2013.

<sup>58</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë të EULEX-it, 3 dhjetor, 2013.

<sup>59</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtarë të doganave, 30 nëntor, 2012.

<sup>60</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë të EULEX-it, 3 dhjetor, 2013.

<sup>61</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë vendorë, 3 dhjetor, 2013.

<sup>62</sup> "Anketa: Kroacia dhe Sllovenia më të korruptuarat në BE", EU Observer, 8 maj, 2013, <http://euobserver.com/justice/120064>

Pasi që Kosova ka përcaktuar integrimin në BE si një ndër prioritetet kryesore të saj, krijimi i një kuadri efektiv institucional dhe ligjor për t'u ballafaquar me çështjen e korrupsionit për këtë arsye është me rëndësi thelbësore. Kjo është në përputhje me kapitullin 23 të BE Acquis i cili thotë se një kornizë solide ligjore dhe institucione të besueshme janë të nevojshme për të përforcuar një politikë koherente të parandalimit dhe pengimit të korrupsionit.<sup>63</sup>

Kushtëzuar nga kriteret e BE-së, vërehej se Kroacia bëri hapa serioze në luftën e saj kundër korrupsionit me themelimin nga Qeveria Kroate në vitin 2001 të Zyrës për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (USKOK), pjesë e Zyrës së Prokurorit të Shtetit. Në mënyrë të ngjashme si Kroacia, institucionet e Kosovës që synojnë integrimin në BE kanë shtyrë reformat, duke përfshirë ndërtimin e mekanizmave dhe ligjeve për të luftuar korrupsionin. Megjithatë, një rast që theu akullin për luftë efektive të Kroacisë kundër korrupsionit ishte aftësia e tyre për të trajtuar raste të profilit të lartë të zyrtarëve shtetërorë të përfshirë në korrupsion si aktakuza nga USKOK dhe dënimi i ish-kryeministrit Ivo Sanader, dhe zyrtarëve të tjerë të nivelit të lartë.<sup>64</sup> Në Kosovë raste të profilit të lartë të korrupsionit mbesin në një nivel të akuzave me disa figura të tjera politike të akuzuar ligjerisht por shpesh që vijnë nga partitë politike më të dobëta sesa nga partia në pushtet e cila vazhdon të garanton imunitet për figurat më të fuqishme politike në shtet. Shpesh presioni politik apo mbajtja e stabilitetit politik është cituar si shkaktar kryesor i numrit të ulët të aktakuzave.<sup>65</sup>

Modeli i USKOK-ut është një shembull i përshtatshëm për homologun e këtij organi në Kosovë, Zyra e Prokurorisë Speciale (PSRK) sidomos për shkak të rezultateve që ajo ka qenë në gjendje të ofrojë në rrugën e Kroacisë drejt BE-së. Edhe pse vendet e ndryshme kanë modele të ndryshme, jo domosdoshmërisht një model që mund të funksionoj në një vend të caktuar do të funksionoj në një vend tjetër,<sup>66</sup> Kosova mund të merr disa praktika të mira nga korniza dhe veprimi i USKOK-ut dhe të përvetësoj aty ku janë të zbatueshme elementet pozitive të këtij organi brenda PSRK-së. Një qasje krahasuese në mes të dy organeve, që përfshinë rezultatet, kornizën dhe kapacitetet ligjore është elaboruar më tej.

#### a. Rezultatet

Gjashtë vjet pas themelimit puna e PSRK-së vazhdon të jetë në nivel jo të kënaqshëm. Raporti i Prokurorit të Shtetit tregon se gjatë vitit 2012 ky institucion ka arritur të zgjidh akuzat vetëm kundër 491 individëve apo 23.26 % nga numri total, ndërsa në fund të vitit kanë qenë 76.26 % raste (me akuzat kundër 1620 individëve) megjithatë deri në fund të 2012 ato nuk janë zgjidhur.<sup>67</sup> Raporti i Progresit 2013 për Kosovën po ashtu ka vërejtur se puna e Prokurorisë Speciale është ngadalësuar, ndërsa ka mungesë të kapacitetit dhe angazhimit për të hetuar krimet që janë nën kompetencën e PSRK-së.<sup>68</sup>

Ndryshe nga PSRK-ja deri në vitin 2012 USKOK-u ka arritur një normë dënimi që tejkalon 95%, me sukses ndjekjen penale ndaj një ish- kryeministri, ish- zëvendës presidentin, një ish gjeneral të nivelit

<sup>63</sup> Shih kapitujt e Acquis në, <http://ec.europa.eu/enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis/>

<sup>64</sup> Një ish-nënkryetar, një ish gjeneral të nivelit të lartë, ish-kryetar i Odës Ekonomike të Kroacisë dhe një kandidat presidencial Nadan Vidosheviç, ish-ministër i brendshëm Ivica Kirin, etj.

<sup>65</sup> Intervistë e KIPRED me Deputetë dhe Prokurorë vendorë dhe ndërkombëtarë, dhjetor 2013.


<sup>66</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë të EULEX-it, 3 dhjetor 2013.

<sup>67</sup> Shih faqe 9, Raportin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës 2012 në, [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti\\_2012\\_Shqip.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Raporti_2012_Shqip.pdf)

<sup>68</sup> Faqja 12 e Raportit të Progresit për Kosovën në,

<http://www.euissuetracker.com/SiteCollectionDocuments/Kosovo%20Progress%20Report%202013.pdf>

të lartë, dhe zyrtarë të tjerë të nivelit të lartë.<sup>69</sup> Sa për ndryshimet ligjore që kanë forcuar strukturën e USKOK-ut prej vitit 2006 e deri në vitin 2012 USKOK ka arritur të dënon 2,185 individë.<sup>70</sup> USKOK-u gjithashtu ka përmirësuar efikasitetin e vet me emërimin e udheheqësit të ri Dinko Cvetan, një zyrtar i njohur për reputacionin e tij për pavarësi politike. Gjatë mandatit të tij janë kryer trajnime të shumta për stafin e USKOK-ut me asistencë të huaj përmes të cilit prokurorët e USKOK-ut kanë fituar kapacitete në metoda moderne të hetimeve në lidhje me korrupsionin.



Cilësia dhe efikasiteti i punës së prokurorisë gjithashtu varet në një masë të madhe nga bashkëpunimi me policinë dhe performancën e tyre. Edhe pse në aspektin e kapaciteteve Policia e Kosovës në përgjithësi vlerësohet në nivel të kënaqshëm,<sup>71</sup> egziston rreziku i ndërhyrjeve politike për shkak të emërimit të tyre në Task Forcën kundër Korrupsionit të PSRK-së, me vendimin e Kryeministrit në vitin 2010 (shih analizën e kapaciteteve). Raporti i Progresit 2013 për Kosovën po ashtu ka theksuar se lidhjet në mes nivelit politik dhe menaxhmentit të policisë vazhdojnë të jenë të afërta.<sup>72</sup>

Është deklaruar shpesh se arsyeja e mungesës së rezultateve nga PSRK-ja ka qenë siguria e pamjaftueshme për stafin e saj. Zyrtarët e EULEX-it deklarojnë se mangësitë janë tek ligji i PSRK-së që nuk parasheh siguri për prokurorët vendorë në nivelin për shembull të paraparë për mbrojtjen e dëshmitarëve, prokurorët vendor pohojnë se prokurorët janë të pajisur me sigurim dhe policia ka kapacitete të mjaftueshme për të vepruar. Megjithatë, problemi kryesor mbetet me vlerësimin e rrezikut që duhet të bëhet për secilin rast veç e veç nga policia varësisht nga disponueshmëria dhe nga burimet njerëzore të policisë. Gjithashtu edhe nëse prokurorit individual i ofrohet mbrojtja, familja e tij nuk përfshihet, dhe kjo mbetet një çështje serioze.<sup>73</sup>

Një nga faktorët që kanë penguar kapacitetin e prokurorëve vendorë në kuadër të PSRK-së për të vepruar është udhëheqja ekskluzive e hetimeve të krimeve të luftës dhe rastet e korrupsionit të profilit të lartë nga ndërkombëtarët. Aktualisht, prokurorët EULEX-it të PSRK-së janë duke planifikuar të fillojnë të përfshijnë më shumë prokurorët vendor duke punuar së bashku në ekipe të përziera.<sup>74</sup> Edhe pse intervenim i vonshëm, është një veprim në drejtimin e duhur pasi që roli i prokurorëve vendorë është zvogëluar dhe për vite u është pamundësuar ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për Kosovën për të trajtuar raste të profilit të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Deri tani PSRK-ja mbetet nën drejtimin e kreut të EULEX-it me raste të krimeve serioze që trajtohen nga prokurorët e EULEX-it. Me një normë mesatare të performancës prej 26 % nga ana

---

<sup>69</sup> Studimi i rastit, Pastrimi i Shtëpise: Kroacia Fshin Nivelin e Lartë të Korrupsionit, 2005-2012 , Gabriel Kuris në, [http://www.princeton.edu/successfulsocieties/content/data/policy\\_note/PN\\_id226/Policy\\_Note\\_ID226.pdf](http://www.princeton.edu/successfulsocieties/content/data/policy_note/PN_id226/Policy_Note_ID226.pdf)

<sup>70</sup> Po aty.

<sup>71</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë të EULEX-it, 3 dhjetor, 2013.

<sup>72</sup> Faqe 49, Raporti i Progresit për Kosovën 2013 në, <http://www.euissuetracker.com/SiteCollectionDocuments/Kosovo%20Progress%20Report%202013.pdf>

<sup>73</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë vendorë, 11 dhjetor, 2013.

<sup>74</sup> Po aty.

e PSRK-së në dënime, mbeten pak mundësi që misioni i PSRK-së do të zbatohet me sukses.<sup>75</sup> Performanca e tyre pengon në masë të madhe mundësinë e vendorëve të marrin përsipër rastet serioze<sup>76</sup> prandaj është e domosdoshme që reformimi i këtij misioni të shoqërohet me forcimin e institucioneve të Kosovës dhe të bëhet tranzicioni drejt një misioni me më shumë monitorim dhe raportim.<sup>77</sup> Ndryshimet e mundshme duhet të synojnë një përqëndrim të autoritetit në duart e PSRK-së duke e mundësuar këtë institucion të jetë organi qendror në luftën kundër korrupsionit dhe krimeve të tjera serioze, ndërsa institucionet e tjera të asistojnë PSRK-në, në mënyrë të ngjashme me shembullin e USKOK-ut.

#### **b. Korniza ligjore e PSRK-së dhe USKOK-ut: Ngjashmëritë dhe dallimet**

PSRK-ja funksionon në bazë të Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës,<sup>78</sup> dhe juridiksioni i kësaj Prokurorie mbulon të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.<sup>79</sup> PSRK-ja është e ngarkuar me kompetenca ekskluzive që të merret me një varg krimesh si krimi i organizuar, terrorizmi, krimet e luftës etj.<sup>80</sup> Përveç kësaj kompetenca shtesë mund të ushtrohen në rastet kur veprat penale mund të rrezikojnë ose kanë rrezikuar "funksionimin ose stabilitetin e shtetit" ... ose "funksionimin ose stabilitetin e institucioneve publike", duke përfshirë edhe rastet e korrupsionit të profilit të lartë.<sup>81</sup> Ndryshe nga ligji USKOK në Kroaci që është ndryshuar disa herë,<sup>82</sup> PSRK-ja në Kosovë vazhdon të veproj me kornizën e njëjtë ligjore që nga themelimi i saj në vitin 2008. Ligji për Prokurorinë Speciale në versionin e tanishëm lejon udhëheqjen kryesore për prokurorët e EULEX-it, lidhur me rastet penale që ndiqen nga Prokurorët Special dmth juridiksion ekskluziv.<sup>83</sup>

Prezenca e shtuar e EULEX-it u ofron prokurorëve të tyre një rol të privilegjuar në krahasim me prokurorët vendorë dhe kjo shpesh dëmton pavarësinë e plotë të prokurorëve vendor dhe kjo u pamundëson atyre zhvillimin e plotë të kapaciteteve të tyre apo të ushtrojnë ato kapacitete veçanërisht në lidhje me rastet e krimeve të rënda.<sup>84</sup> Nga ana tjetër, studimi i fizibilitetit i BE-së për Kosovën në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit kërkon që Kosova duhet të sigurojë gjatë implementimit të strukturës së gjykatave se Prokuroria Speciale, përgjegjëse për rastet e krimit të organizuar, krimeve të luftës dhe korrupsionit mban kompetencat e veta dhe gjithashtu në mënyrë aktive mbështet implementimin e mandatit të EULEX-it, duke përfshirë edhe Task Forcën për Hetime Speciale.<sup>85</sup>

---

<sup>75</sup> Raport i KIPRED "Analizë Gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Çka më tutje?"

[http://www.kipred.org/advCms/documents/56243\\_A\\_Comprehensive\\_Analysis\\_of\\_EULEX.pdf](http://www.kipred.org/advCms/documents/56243_A_Comprehensive_Analysis_of_EULEX.pdf)

<sup>76</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë vendorë, 2013.

<sup>77</sup> Raport i KIPRED "Analizë Gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Çka më tutje?"

[http://www.kipred.org/advCms/documents/56243\\_A\\_Comprehensive\\_Analysis\\_of\\_EULEX.pdf](http://www.kipred.org/advCms/documents/56243_A_Comprehensive_Analysis_of_EULEX.pdf)

<sup>78</sup> Nr.03/L-052, Shih, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L052\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L052_en.pdf)

<sup>79</sup> Shih, <http://www.psh-ks.net/?page=2,16>

<sup>80</sup> Shih faqe 5, Ligjin e PSRK-se në, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L052\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L052_en.pdf)

<sup>81</sup> Shih nenin 10.2 paragrafi (d) të ligjit PSRK, në [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L052\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L052_en.pdf)

<sup>82</sup> Ligji për Zyrën e Shtypjes së Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (USKOK) Akti mbi Zyrën e Shtypjes së Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (NN 76/09, 116/10,145/10, 57/11, 136/12) në, <http://www.dorh.hr/Default.aspx?sec=608>

<sup>83</sup> Shih nenin 16, dispozitat kalimtare në, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L052\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L052_en.pdf)

<sup>84</sup> Raport i KIPRED "Analizë Gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Çka më tutje?"

[http://www.kipred.org/advCms/documents/56243\\_A\\_Comprehensive\\_Analysis\\_of\\_EULEX.pdf](http://www.kipred.org/advCms/documents/56243_A_Comprehensive_Analysis_of_EULEX.pdf) dhe Intervistë e KIPRED me Prokurorë vendorë, dhjetor 2013.

<sup>85</sup> Faqe 7 dhe 8, Studimi i Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet

Bashkimi Evropian dhe Kosoves në,

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_feasibility\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_feasibility_2012_en.pdf)

Kohëve të fundit, ka pasur përpjekje për të ndryshuar ligjin e PSRK-së veçanërisht në lidhje me kompetencat e PSRK-së lidhur me krimet e rënda. Ligji i PSRK-së ende i referohet kodit të procedurës penale të vitit 2003 pa reflektuar Kodet e reja që kanë hyrë në fuqi në vitin 2013. Prokurorët e EULEX-it kanë raportuar se disa ndryshime të ligjit janë planifikuar që të ndërmarrën së shpejti, por nuk dihet se në çfarë drejtimi do të përfundojnë ndryshimet.<sup>86</sup> Ministria e Drejtësisë së Kosovës ka deklaruar për KIPRED-in se qëllimet për ndryshimin e ligjit janë diskutuar megjithatë procesi ende nuk ka filluar.<sup>87</sup> Prokurorët e EULEX-it<sup>88</sup> thonë se në qoftë se ndonjë ndryshim ndodhë është e rëndësishme që udhëheqësia në luftën kundër korrupsionit të mbetet tek PSRK-ja.

Kur është fjala për USKOK-un ky institucion ka ndërtuar kapacitetet dhe partneritetet institucional brenda dhe jashtë Kroacisë duke u bërë ndër institucionet<sup>89</sup> më të besuara. Struktura formale dhe kompetencat e USKOK-ut janë projektuar në mënyrë që ta bëjnë këtë institucion autoritet kryesor shtetëror në parandalimin dhe eliminimin e korrupsionit në Kroaci.<sup>90</sup> Që nga themelimi, autoriteti i saj ligjor është rritur me kalimin e kohës me vullnetin këmbëngulës politik për të mbështetur edhe strukturën, nevojat në burime njerëzore dhe nevojat buxhetore të zyrës.<sup>91</sup> Ligji i parë për USKOK-un u miratua në vitin 2001 nga Parlamenti Kroat megjithatë për shkak të mbështetjes politike të kufizuar mandati i USKOK nuk ishte mjaft i fortë. Pas ndryshimeve të vitit 2003 dhe 2005 kompetencat dhe autoriteti i USKOK-ut u zgjerua.<sup>92</sup> Ndryshimet e ligjit filluan në mënyrë që të përmirësohet bashkëpunimi dhe koordinimi mes USKOK-ut, gjykatave dhe policisë gjithashtu duke qartësuar strukturën e këtij bashkëpunimi.<sup>93</sup>

Këto ndryshime të reja i kanë dhënë prokurorëve të USKOK-ut më shumë fuqi në mesin e tyre të shërbimeve të tjera prokuroriale përfshirë këtu edhe autoritetin për të përdorur metodat speciale të hetimit si infiltrim të fshehtë, operacione goditëse (kapjen e personit duke kryer veprën penale), dhe mbikqyrjes së mjeteve të telekomunikacionit. Për më tepër, numri i krimeve me të cilët USKOK-u mund të merrej u rrit dhe organet tjera ishin të detyruar të ndihmojnë USKOK-un në hetimet e saj. Për shembull USKOK-ut i lejohet të inspektojë të dhënat financiare personale dhe operacionet e biznesit dhe të ngrin asetet pas miratimit gjyqësor.<sup>94</sup> Me ndryshimet e vitit 2005 departamenti për bashkëpunim ndërkombëtar dhe hetime të përbashkëta është themeluar për të plotësuar departamentet tjera funksionale të USKOK-ut të tilla si prokuroria, hulumtimet dhe dokumentacioni.<sup>95</sup>

Kur është fjala për kapacitetet e USKOK-ut dhe PSRK-së, korniza ligjore e USKOK-ut përshkruan strukturën e këtij organi, ndërsa në ligjin e PSRK-së struktura e organit nuk është e përcaktuar qartë, është e paqartë me terminologji komplekse ligjore dhe strukturore që është e hartuar ekskluzivisht për tu përpëthur me përgjegjësitë e prokurorëve ndërkombëtarë duke përmendur pak kapacitetet dhe

---

<sup>86</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtar të EULEX-it, 3 dhjetor, 2013.

<sup>87</sup> Komunikim me e-mail i KIPRED me zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë, janar 2013.

<sup>88</sup> Intervistë e KIPRED me zyrtar të EULEX-it, 3 dhjetor, 2013.

<sup>89</sup> Shih Studimi i rastit, Pastrimi i Shtëpisë: Kroacia Fshin Korrupsionin e Nivelit të Lartë, 2005-2012, Gabriel Kuris në, [http://www.princeton.edu/successfulsocieties/content/data/policy\\_note/PN\\_id226/Policy\\_Note\\_ID226.pdf](http://www.princeton.edu/successfulsocieties/content/data/policy_note/PN_id226/Policy_Note_ID226.pdf)

<sup>90</sup> Faqe 91, Institucionet e specializuara kundër korrupsionit, Shqyrtimi i modeleve, Rrjeti Anti-Korrupsion për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, <http://www.oecd.org/corruption/acn/39971975.pdf>

<sup>91</sup> Shih më shumë në lidhje me USKOK, <http://www.dorh.hr/Default.aspx?sec=53>

<sup>92</sup> Shih Studimi i rastit, Pastrimi i Shtëpisë: Kroacia Fshin Korrupsionin e Nivelit të Lartë, 2005-2012, Gabriel Kuris në, [http://www.princeton.edu/successfulsocieties/content/data/policy\\_note/PN\\_id226/Policy\\_Note\\_ID226.pdf](http://www.princeton.edu/successfulsocieties/content/data/policy_note/PN_id226/Policy_Note_ID226.pdf)

<sup>93</sup> Faqe 91, Institucionet e specializuara kundër korrupsionit, Shqyrtimi i modeleve, Rrjeti Anti-Korrupsion për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, <http://www.oecd.org/corruption/acn/39971975.pdf>

<sup>94</sup> Shih Studimi i rastit, Pastrimi i Shtëpisë: Kroacia Fshin Korrupsionin e Nivelit të Lartë, 2005-2012, Gabriel Kuris në, [http://www.princeton.edu/successfulsocieties/content/data/policy\\_note/PN\\_id226/Policy\\_Note\\_ID226.pdf](http://www.princeton.edu/successfulsocieties/content/data/policy_note/PN_id226/Policy_Note_ID226.pdf)

<sup>95</sup> Po aty.



përgjegjësitë vendore. Derisa lista e krimeve është e listuar në ligjin e PSRK-së, departamentet përgjegjëse nuk janë të paraqitura në mënyrë të qartë dhe listimi në strukturën e organeve të tjera kompetente që duhet të punoj nën autoritetin e PSRK-së nuk është përmendur fare.<sup>96</sup> Edhe pse PSRK-ja ka një strukturë organizative, koordinimi dhe bashkëpunimi i saj me institucionet e tjera nuk është i përcaktuar qartë siç ndodh në rastin e USKOK-ut. Kjo dobësi është konfirmuar edhe nga prokurorët e EULEX-it që janë të mendimit se të gjitha rastet e korrupsionit duhet të trajtohen dhe të procesohen ekskluzivisht nga PSRK-ja.<sup>97</sup> Me ndryshimet në ligjin për Gjykatat<sup>98</sup> dhe Kodit Penal<sup>99</sup> korniza ligjore e PSRK-së është përmirësuar por fushëveprimi i saj vazhdon të jetë i shpërndarë në më shumë se një ligj. Shefi i USKOK-ut, ofron raporte mujore të rregullta Prokurorit të Përgjithshëm Kroat pasi që është nën mbikëqyrjen e asaj zyre. USKOK është i autorizuar më tej për të kryer të gjitha hetimet penale në kuptimin që në praktikë prokurorët e USKOK-ut kërkojnë informacione direkte nga ministritë e tjera sidomos nga departamentet të kontrollit të brendshëm.<sup>100</sup> Komunikimi bëhet në formë të shkruar përveç rasteve të koordinimit direkt në baza të rregullta me policinë e zbulimit të krimit dhe me administratën tatimore. Të gjitha këto organe janë përgjegjëse të ofrojnë direkt dhe të ekzekutojnë tek prokurorët e USKOK-ut . Kjo përmendet qartë në ligjin mbi USKOK që këto institucione duhet të ofrojnë asistencë dhe të japin të dhëna direkt në USKOK.<sup>101</sup> Nëse informacioni i kërkuar nga institucionet vonohet atëherë kjo konsiderohet një shkelje e rëndë e punës ose e detyrave zyrtare. Ndryshe, prokurorët ndërkombëtarë të Kosovës lëvdojnë punën dhe bashkëpunimin me policinë megjithatë edhe kur adresohen institucionet e tjera drejtpërdrejt me shkrim përgjigjet vonohen për prokurorët.<sup>102</sup> Mungesa e strukturës së qartë të departamenteve, bashkëpunimit dhe kompetencave ekskluzive të prokurorëve ndërkombëtarë të EULEX-it e bën këtë strukturë krejt të kundërt nga ajo që parasheh ligji i USKOK -ut.

Ndryshe nga USKOK-u , PSRK-ja ka mandatin e vet ekskluziv për t'u marrë me krimet e luftës. Për shkak të natyrës së tyre të ndjeshme rastet e krimeve të luftës të ndërmarra nga PSRK-ja zakonisht janë të pasuara me protesta dhe kundërshtime nga qytetarët e Kosovës për shkak se shumica e të akuzuarve vijnë nga komuniteti shqiptar në veçanti komandantët dhe anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Është interesante por nuk kanë ndodhur reagime të ngjashme qytetare kur të njëjtët persona janë akuzuar për afëra të korrupsionit gjë që tregon vullnetin shoqëror dhe mbështetjen për EULEX-in për të luftuar korrupsionin.<sup>103</sup> Përfshirja e krimeve të luftës në fushëveprimin e PSRK-së ka bërë që PSRK-ja kryesisht të merret me rastet e krimeve të luftës duke ulur kapacitetet e tyre për të trajtuar rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Një zgjidhje e mundshme për ndryshimet e parashikuara të ligjit të PSRK-së duhet të shqyrtojë me kujdes mundësinë e ndarjes së fushëveprimit të mandatit, njerëzor dhe burimet buxhetore të Zyrës. Kujdesi

---

<sup>96</sup> Shih Ligjin për PSRK-në, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L052\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L052_en.pdf) Ligjin për USKOK, [http://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2009\\_07\\_76\\_1834.html](http://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2009_07_76_1834.html)

<sup>97</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorët të EULEX-it, PSRK-së, dhjetor 2013.

<sup>98</sup> Shih Ligjin në,

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20amend%20the%20law%20on%20courts.pdf>

<sup>99</sup> Shih Ligjin në,

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/129%20Law%20on%20amending%20the%20criminal%20code%20of%20Kosovo.pdf>

<sup>100</sup> Shih Rrjeti Kundër Korrupsionit për Ekonomitë në Tranzicion, Mbledhja e Përgjithshme e 6-të, 30-31 maj 2005, Prezantimet e Stambollit nga Seanca 2 për institucionet e specializuara kundër korrupsionit në

<http://www.oecd.org/corruption/acn/aboutthenetwork/37330595.pdf>

<sup>101</sup> Po aty.

<sup>102</sup> Intervistat e KIPRED me Prokurorë të EULEX-it, dhjetor 2013.

<sup>103</sup> Fatmir Limaj një ish-komandant i UÇK-së akuzohet për krim të organizuar dhe vepra të tjera që lidhen me korrupsionin në rastin e Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (MTP). Rasti është në vazhdim e sipër. Shih, <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0372.php>. Në shtator 2013 Limaj u shpall i pafajshëm për krime të luftës dhe vepra penale të lidhura në rastin "Kleçka". Shih, <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0485.php>. Shih, <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0509.php>

i veçantë ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit gjithashtu mund të përmirësoj kapacitetet dhe efikasitetin e institucioneve të Kosovës për të luftuar rastet e korrupsionit të profilin të lartë të lidhura edhe me rrjetet e krimit të organizuar.

### c. Kapacitetet

Deri në shkurt 2010, PSRK-ja ka operuar me një mesatare prej gjashtë prokurorëve special të EULEX-it dhe gjashtë prokurorë special vendor. Pas shkurtit të vitit 2010, janë emëruar dhjetë prokurorë tjerë special vendor si dhe një nënkryetar siç parashihet në Ligjin për PSRK-në. Deri në qershor 2011, PSRK-ja përbëhej nga 11 prokurorë ndërkombëtarë, dhjetë prokurorë të Kosovës dhe personelit ndihmës (përfshirë këtu edhe pesë ekspertë financiarë në Task Forcën Anti - Korrupsion).<sup>104</sup> Ndër sfidat kryesore të PSRK-së është interesi i prokurorëve për të aplikuar për pozicionet e lira. Sipas EULEX-it në përgjithësi ka pasur një mungesë të prokurorëve kompetent dhe një rënie në cilësinë e stafit.<sup>105</sup> Kur PSRK-ja lëshoi një thirrje për disa vende të lira për prokurorë, me qëllim për të balancuar numrin e personelit vendor me atë të EULEX-it siç është paraparë me ligjin e PSRK-së, askush nuk aplikoi për këto pozita. Këto pozita janë mbushur vetëm pasi Prokurori i Shtetit organizoi ekipe mobile në rajone të ndryshme në mënyrë që të rekrutohen dhe të caktohen pozitat për PSRK-në.<sup>106</sup> Një vrojtim i përgjithshëm është se prokurorët ndjehen të frikësuar për shkak të ndjeshmërisë së pozitës dhe për shkak të sulmeve të vazhdueshme kundër prokurorëve nga ana e mediave, ndërkohë që KPK dhe KGJK kanë bërë pak për të mbrojtur punën e prokurorëve. Një çështje tjetër shqetësuese është edhe rrjedhja e informatave lidhur me hetimet dhe dëshmitë në publik.<sup>107</sup>

Sa i përket USKOK-ut , në fillim të krijimit ky institucion kishte mungesë të resurseve dhe kjo çoi në një përgjigje joefektive. Kjo ndryshoi vetëm katër vjet më pas me mbështetjen vendimtare politike ku USKOK-ut iu dhanë fuqi të reja ligjore dhe udhëheqje e re. Një trend pozitiv i praktikuar nga USKOK janë investimet e vazhdueshme në ndërtimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve të cilëve iu janë ofruar programe trajnimi brenda dhe jashtë Kroacisë.<sup>108</sup> Në fazën fillestare të krijimit të USKOK-ut pati interesimi të ulët nga ana e ekspertëve që punojnë në kontabilitet, kriminologji, tatimet - të jenë pjesë e strukturës së USKOK-ut për shkak të pagave të ulëta të ofruara. Për dallim Kroacia ofroi qindra euro paga më të mira për prokurorët e USKOK-ut, në këtë mënyrë duke joshur prokurorët në zyrë.<sup>109</sup> Në mënyrë të ngjashme edhe PSRK-ja gjithashtu ofron paga më të mira për prokurorë special vendor në krahasim me prokurorët në nivele të tjera megjithatë pagat nuk duket se stimulojnë prokurorët vendorë për punë. Prokurorët special vendorë përmendin sigurinë e familjeve të tyre dhe sigurinë e tyre si shqetësimin e tyre kryesor dhe gjithashtu ndërhyrjen e mediave në punën e tyre.<sup>110</sup>

Pjesë e strukturës së USKOK-ut sipas ligjit janë gjashtë departamente: Departamenti i Hulumtimeve dhe Dokumentacionit, Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit dhe Marrëdhënie me Publikun, Departamenti i Prokurorëve, Departamenti për bashkëpunim ndërkombëtar dhe hetime të

---

<sup>104</sup> Faqe 23 dhe 24, Kosovë: Koha që EULEX tu jep Prioritet Krimeve të Luftës, Amnesty International në, <http://www.amnesty.org/en/library/asset/EUR70/004/2012/en/3090bbe1-6da2-43af-9415-ac06fa3a54a2/eur700042012en.pdf>

<sup>105</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë të EULEX-it, 3 dhjetor, 2013.

<sup>106</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë të EULEX-it, 3 dhjetor, 2013.

<sup>107</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë të EULEX-it, 3 dhjetor, 2013.

<sup>108</sup> Shih më shumë në lidhje me USKOK në, <http://www.dorh.hr/Default.aspx?sec=53>

<sup>109</sup> Shënimin e mësipërm në 86.

<sup>110</sup> Burim i KIPRED, Prokurorë vendorë.

përbashkëta, Sekretariatit dhe shërbimet Ndhimëse.<sup>111</sup> Përveç prokurorëve të specializuar ka gjyqtarë të specializuar penal që janë të vendosur në katër gjykatat më të mëdha të qarkut në Kroaci, në Zagreb, Rijeka, Split dhe Osijek, dhe janë përgjegjës për gjykimin e rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Këto raste marrin prioritet të lartë në sistemin e drejtësisë.<sup>112</sup> Në përputhje me shtrirjen e USKOK-ut PSRK-ja mund të krijoj degë në rajonet kryesore të Kosovës në mënyrë që të ketë shtrirje më të madhe dhe kapacitet për t'u ballafaquar me rastet lokale dhe rajonale kur është e nevojshme.

Me një strukturë të ofruar në mënyrë eksplicite USKOK gjithashtu përbëhet nga Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit dhe Marrëdhënie me Publikun. PSRK-ja vazhdon të punojë në rastet kundër korrupsionit nëpërmjet një Task Force Anti-Korrupsion që gjithashtu përbëhet nga hetuesit e policisë të emëruar në bazë të një vendimi të vitit 2010 nga Kryeministri i Kosovës duke ndërhyrë drejtpërdrejt në pavarësinë e shërbimeve të prokurorisë.<sup>113</sup> Task Forca ka në strukturën e saj pesë ekspertë me përvojë në çështjet e tatimeve dhe krimeve të lidhura me korrupsionin.<sup>114</sup> USKOK-u ka një makineri të tërë të oficerëve të policisë si pjesë e strukturës në përputhje me ligjin e njohur si Policia USKOK (PUSKOK) ndërsa Task Forca Kundër Korrupsionit e Kosovës varet nga gatishmëria e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Policisë së Kosovës për emërimin e oficerëve të Task Forcës. Aktualisht janë rreth 30 policë që nuk bien nën procesin e rekrutimit dhe menaxhimit nga PSRK-ja.<sup>115</sup> Prokurorët special vendorë kanë theksuar këtë si një mangësi të madhe për punën e tyre duke u mbështetur në punonjësit e policisë të emëruar nga qeveria me ish-policinë gjyqësore të paraparë në Kodin Penal të vitit 2003 krejtësisht të shkëputur nga kodi aktual penal.<sup>116</sup> Në të kaluarën ka pasur disa raste kur hetimi që përfshinte elitën politike nuk trajtohej në mënyrën e duhur nga ana e zyrtarit të policisë që udhëheqte rastin.<sup>117</sup> Prandaj për të forcuar performancën e punës së PSRK-së një mundësi që duhet të merret në konsideratë është të ndryshohet ligji i PSRK-së në mënyrë që një njësi e zyrarëve të policisë të jetë nën strukturën e rekrutimit dhe menaxhimit të PSRK-së.

Puna e PSRK-së pengohet shpesh nga mungesa e koordinimit me institucionet e tjera të drejtësisë në Kosovë. Në nenin 6 të ligjit PSRK<sup>118</sup> thuhet se të gjitha institucionet duhet ti raportojnë PSRK-së dhe ka pasur raste kur disa institucione nuk kanë qenë të gatshme për ta bërë këtë, ose të veprojnë në kohën e duhur duke vonuar hetimet. Për shembull, një prokuror special është detyruar të kërcënoj një auditor se do të dërgojë policinë për të përmbushur kërkesën e saj me shkrim për informata. Zyra vononte të jep përgjigjen e kërkuar disa ditë.<sup>119</sup> Në rastin e Kroacisë, për ti zvogëluar pengesat e tilla ligji i USKOK-ut ofron struktura të qarta të raportimit duke krijuar memorandume mirëkuptimi me ministrinë dhe agjencitë relevante për të krijuar mënyra të kontrolluara për qasje në bazat e të

---

<sup>111</sup> Shih vendimin e Parlamentit kroat që të shpallë Zyrën për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në, [http://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2009\\_07\\_76\\_1834.html](http://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2009_07_76_1834.html)

<sup>112</sup> "Korrupsioni në Kroaci", Global Security, <http://www.globalsecurity.org/military/world/europe/hr-corruption.htm>

<sup>113</sup> Shih faqe 20, raportin e KIPRED, "Forcimi i Sundimit të Ligjit në Kosovë: Konfiskimin i Pronave të Perfituara në Mënyrë të Kundërligjshme" në,

[http://www.kipred.org/advCms/documents/98577\\_Confiscation\\_of\\_illegally\\_obtained\\_property.pdf](http://www.kipred.org/advCms/documents/98577_Confiscation_of_illegally_obtained_property.pdf)

<sup>114</sup> Vendimi i Qeverisë së Kosovës i 26 shkurtit, 2010, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_110\\_-te\\_te\\_Qeverise\\_2010.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_110_-te_te_Qeverise_2010.pdf)

<sup>115</sup> Vendimi i Qeverisë së Kosovës i 26 shkurtit, 2010, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_110\\_-te\\_te\\_Qeverise\\_2010.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_110_-te_te_Qeverise_2010.pdf)

<sup>116</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë vendorë, 11 dhjetor, 2013

<sup>117</sup> Burim i KIPRED, Prokurorë vendorë.

<sup>118</sup> Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës në, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L052\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L052_en.pdf)

<sup>119</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë të EULEX-it, dhjetor, 2013.

dhënave të tyre. Kjo i ka mundësuar USKOK-un të ushtrojë fuqitë e tij të veçanta të kontrollit të të dhënave financiare pa shkelur privatësinë e qytetarëve.

Departamenti i USKOK-it për Parandalimin e Korrupsionit llogaritet në zyrën e Marrëdhënieve me Publikun të paraparë me ligj. Kjo nuk ndodh me ligjin e PSRK-së që gjithashtu cilësohet me mungesë të transparencës nga PSRK-ja.<sup>120</sup> Nga ana tjetër prokurorët vendorë dhe ndërkombëtarë të PSRK-së i nënshtrohen presionit të lartë nga mediat me rastet nën hetime ku shpesh ndodh që dëshmitë të rrjedhin tek mediat. Nëse ndonjë rast i veçantë ishte nën hetime rreth tetë javë rresht shkruhej për atë prokuror në një media të caktuar.<sup>121</sup> As PSRK-ja e as shërbimet e prokurorisë shtetërore në këtë rast nuk u dalin në mbrojtje të rasteve veçanërisht për shkak të rrezikut të akuzohen për presionin ndaj mediave. Zgjidhje e mundshme mund të gjendet në Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës që të lëshohen deklaratatë të fuqishme për dënimin e rrjedhjes së informatave dhe presionin mbi personelin gjyqësor.<sup>122</sup> Megjithatë, vullneti dhe mbështetja e leadershipit politik është e nevojshme pasi që ndodh shpesh që dëshmitë të rrjedhin në media nga individë të veçantë në pushtet që janë nën hetime.<sup>123</sup>

Në anën tjetër, USKOK-u ka arritur të ndërtojë marrëdhënie të mira me mediat duke deklaruar se marrëdhëniet e forta me mediat janë të domosdoshme për të ndërtuar besimin publik pasi që mediat mund të informojnë opinionin publik në lidhje me aktivitetet e tyre dhe për të forcuar opinionin publik. Kjo u arrit përmes takimeve me gazetarët në mënyrë që të shpjegohet se si punon USKOK, duke dhënë përgjigje për pyetje publike, përditësimi në faqën e internetit të USKOK-it dhe pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnim për media për të përmirësuar aftësitë e tyre për t'iu përgjigjur pyetjeve të mediave pa e rrezikuar rastin. Diçka e ngjashme është bërë në marrëdhëniet me OJQ-të gjithashtu.<sup>124</sup> PSRK-ja vazhdon të jetë e mbyllur larg nga mediat pa konferenca të rregullta për shtyp dhe më nuk ofrojnë raporte speciale të prokurorisë prej vitit 2011.

Një tjetër shembull i mirë që vjen nga USKOK është Departamenti i Hulumtimit dhe Dokumentacionit, një degë që i mungon PSRK-së në Kosovë. PSRK-ja mund të bëjë hulumtime për nevojat e veta mirëpo një departament i tillë nuk është i paraparë me ligj. Për më tepër, në kuadër të këtij departamenti USKOK-u krijon dhe mban një bazë të dhënash që mund të shërbejë si një burim i dijes në procesin e veprave penale, përcjelljen e rasteve dhe të raportimit.<sup>125</sup> PSRK-ja dhe organet tjera të sundimit të ligjit në Kosovë si KGJK dhe KPK janë ende duke tentuar për të zhvilluar një bazë të të dhënash të përbashkët në përcjelljen e punës së tyre. Një përcjellje e besueshme e rasteve është e domosdoshme për një luftë efektive kundër korrupsionit. Në raportin e vitit 2012 Gjykata Evropiane e Auditorëve<sup>126</sup> ka deklaruar se mungesa e bazës së të dhënave, sidomos në mes të policisë dhe prokurorëve, është një mangësi e madhe që ndikon në bashkëpunimin në mes të institucioneve të sundimit të ligjit.

---

<sup>120</sup> Shih faqe 3, Lëvizja FOL përmbledhje e politikave, Ndikimi i vendimeve të Qeverisë në luftën kundër korrupsionit 2010-2011 në, [http://levizjafol.org/images/uploads/files/Policy\\_Brief\\_-\\_The\\_Impact\\_of\\_Government\\_Decisions\\_in\\_the\\_Fight\\_Against\\_Corruption-2.pdf](http://levizjafol.org/images/uploads/files/Policy_Brief_-_The_Impact_of_Government_Decisions_in_the_Fight_Against_Corruption-2.pdf).

<sup>121</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë të EULEX-it, 3 dhjetor, 2013.

<sup>122</sup> Intervistë e KIPRED me Prokurorë të EULEX-it, 3 dhjetor, 2013.

<sup>123</sup> Shënimin e mësipërm në 116.

<sup>124</sup> Studimi i rastit, Pastrimi i Shtëpise: Kroacia Fshin Nivelin e Lartë të Korrupsionit, 2005-2012, Gabriel Kuris në, [http://www.princeton.edu/successfulsocieties/content/data/policy\\_note/PN\\_id226/Policy\\_Note\\_ID226.pdf](http://www.princeton.edu/successfulsocieties/content/data/policy_note/PN_id226/Policy_Note_ID226.pdf)

<sup>125</sup> Vendimi i Parlamentit kroat për shpalljen e Zyrës për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, [http://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2009\\_07\\_76\\_1834.html](http://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2009_07_76_1834.html), Artikulli 14, i 2-të.

<sup>126</sup> Shih faqe 18, Gjykata Evropiane e Auditorëve 2012, Raport Special Nr 18, në <http://eca.europa.eu/portal/pls/portal/docs/1/17766744.PDF>

### **c) KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME**

Gjashtë vjet pas shpalljes së pavarësisë, Kosova vazhdon të vlerësohet si një vend shumë i korruptuar. Përveç raporteve vendore dhe ndërkombëtare që deklarojnë një gjë të ngjashme, edhe qytetarët e Kosovës ndajnë të njëjtën përshtypje në lidhje me nivelin e korrupsionit. Korrupsioni është i përhapur në institucionet kryesore të vendit dhe prania e tij e lartë në gjyqësor është një çështje shqetësuese.

Kosova nuk do të jetë në gjendje të lëviz drejt Bashkimit Evropian pa siguruar një luftë efektive kundër korrupsionit pasi që kjo është një ndër kërkesat kryesore të BE-së. Një koordinim më i fortë nevojitet në mesin e organeve të sundimit të ligjit me vullnet konkret politik për të forcuar mekanizmat ekzistues të tillë si PSRK-ja me mandat të mjaftueshëm, duke përfshirë strukturën e raportimit dhe koordinimit si dhe buxheti do të ndihmojnë në rritjen e efikasitetit në luftën e përgjithshme kundër korrupsionit. Për më tepër, një luftë e suksesshme kundër korrupsionit nuk mund të arrihet përderisa qeveria lëshon deklarata se sundimi i ligjit është në mesin e prioriteteve të tyre kryesore, ndërsa në anën tjetër vazhdon të ndajë 2.17 % të buxhetit vjetor për organet kryesore të sundimit të ligjit.

Krijimi i organeve të shumta për të luftuar korrupsionin ka shkaktuar një përplasje në mandate, joefikasitet, rritjen e mungesës së përgjegjësisë dhe ulje të numrit të dënimeve. Kjo duket të jetë një taktikë e vazhdueshme e qeverisë për të krijuar dhe caktuar Koordinatorë të ri ose Task Forca posa të rritet presioni nga BE-ja. Kjo vazhdon të pengojë ligjet ekzistuese dhe mekanizmat në implementim, dhënien e buxhetit në drejtime të ndryshme ndërsa rezultatet në luftën kundër korrupsionit si raste të pazgjdhura vetëm barten nga viti në vit. Përveç kësaj, përderisa akuzat penale janë rritur në nivelin e prokurorive të përgjithshme të shtetit, numri i lëndëve të pazgjdhura është shqetësues kryesisht duke u ballafaquar me raste të vogla të korrupsionit kështu duke zhvendosur vëmendjen nga rastet e profilit të lartë.

Thjeshtësimi i rolit dhe përgjegjësisë së secilit institucion me institucionet udhëheqëse të caktuara në luftën kundër korrupsionit është shansë që Kosova nuk duhet të humbasë. Për më tepër, reformat në vazhdim e sipër në mandatin aktual të EULEX-it kombinuar me një kushtëzim të fortë nga ana e BE-së ndaj institucioneve të Kosovës duhet gjithashtu të përfshijnë transferimin e kompetencave të organeve të sundimit të ligjit në strukturat vendore, krahas me rritjen e kapaciteteve të tyre.

Së fundi , Kosova mund të përdorë mësimet dhe praktikat nga vendet e tjera që kanë luftuar me sukses korrupsionin si për shembull Kroacia. Zyra për Luftën Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është analizuar si model për Kosovën për të përdorur dhe potencialisht të përshtatet me mandatin e Prokurorisë Speciale të Kosovës. Përveç kësaj, reforma e PSRK-se është e nevojshme që kjo Prokurori të rrit efikasitetin e saj. Për më tepër, për të eliminuar mundësinë e zvoglimit të kapaciteteve të prokurorëve të PSRK-së për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, një ndarje e krimeve të luftës nga PSRK-ja është e nevojshme në mënyrë që ti jepet krimin të organizuar dhe korrupsionit vëmendja e duhur.

Në përputhje me fushëveprimin e USKOK-ut PSRK-ja e reformuar duhet të jetë autoriteti udhëheqës në vend posaçërisht në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar me një strukturë të qartë të punonjësve të tyre të policisë, prokurorëve special dhe ekspertëve. Për më tepër, duke përfutur nga praktikat e mira të USKOK-ut, PSRK-ja në Kosovë duhet të rrit transparencën e saj nëpërmjet përforsimit të marrëdhënieve të saj me publikun.

KIPRED propozon rekomandimet e mëposhtme për përmirësimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe rritjen e efikasitetit të PSRK-së:

- **Fuqizimi i legjislacionit për PSRK-në:** Duke përdorur shembullin e ligjit kroat për USKOK-in, të ndryshojë Ligjin mbi PSRK-në për të përfshirë një mandat të qartë për prokurorët special të Kosovës, të hartojë një kornizë të vetme ligjore duke përfshirë strukturën dhe përbërjen e PSRK-së me një menaxhim dhe strukturë të qartë organizative në lidhje me atë se kush kujt i raporton, roli i PSRK-së për korrupsionin dhe luftën kundër krimit të organizuar duhet të definohet si i udhëheqësit, duke përfshirë qasje të pakufizuar në të gjitha nivelet e informacioneve të kërkuara për rastet e hetimeve të profilit të lartë, dhe duhet tu ofrohet mbrojtje e plotë prokurorëve specialë dhe familjeve të tyre.
- Më tej hetimet dhe aktakuzat nga PSRK-ja duhet gjithashtu të trajtohen nga gjyqtarët specialë ose nga dhoma e posaçme, si në rastin e USKOK-ut, dhe ligji i PSRK-së duhet të krijojë policinë e PSRK-së sikurse në modelin e policisë së USKOK-ut nën rekrutim dhe strukturë të menaxhimit të drejtpërdrejt nga PSRK-ja. Raportimet dhe monitorimet në lidhje me përcjelljen e menaxhimit të rasteve nga hetimi, aktakuza, aktgjykimi dhe vendimet e formës së prerë duhet të mblidhen nga PSRK-ja dhe të publikohen në baza të rregullta. Ky ligj duhet pra të qartësojë dispozitat përplasëse ekzistuese në Kodin Penal të Kosovës, Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Gjykata të rregullta.
- **Dyfishim i fondeve për PSRK-në:** Qeveria e Kosovës duhet të dyfishojë fondet për PSRK-në deri në 1,120,000.00 € (nga shuma e tanishme prej 593,000.00 €) i bazuar në modelin kroat të përdorimit prej 0,62 € për kokë banori për anti-korrupsion dhe luftën kundër krimit të organizuar. Kosova aktualisht ndan vetëm 0,32 € për kokë banori në këto përpjekje.
- **Të shfuqizojë organet e paefektshme institucionale:** Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit nga Zyra e Presidentit, Task Forca dhe/ose njësitë speciale anti-korrupsion; si dhe Koordinatori Kombëtar për Anti-Korrupsion në kuadër të Prokurorisë së Shtetit. Shfuqizimi i këtyre mekanizmave duhet të ndiqet nga mbështetja e plotë politike, ligjore dhe financiare për të forcuar mandatin e përgjithshëm të PSRK-së i cili duhet të ketë rol udhëheqës në luftën kundër korrupsionit dhe luftën kundër krimit të organizuar.
- **Udhëheqje e përbashkët e PSRK-së nga prokurorë të EULEX-it dhe Kosovës:** Në mënyrë që Kosovës t'i sigurohet më shumë pronësi në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, PSRK-ja duhet të udhëhiqet bashkarisht nga dy kryesues – një prokuror shtetëror i Kosovës dhe një prokuror i EULEX-it për një afat kohor me kohëzgjatje të kufizuar 2 vjeçare. Pas dy vjetësh, PSRK-ja duhet të kryesohet tërësisht nga Prokurorët kosovarë.
- **Kërkesat e kryesuesit të PSRK-së së Kosovës:** Prokurori shtetëror i Kosovës, bashkë-kryesuesi i PSRK-së, duhet të gëzojë reputacion të shkëlqyer, me një minimum prej 10 vjet pune në Prokurorinë Speciale, i pavarur nga përkatësia politike, dhe me një histori të shkëlqyer të të dhënave.